



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Morfologji e gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti II , semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse - Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim.

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Në përfundim të modulit studenti duhet:të përcaktojë konceptet bazë të morfologjisë (kuptimi gramatikor, forma gramatikore, kategoria gramatikore).Të njohë dhe diferencojë konceptet bazë të morfologjisë;Të ushtrojë kompetencën ligjërimore gramatikore saktë dhe lirshëm. Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyetojë mbi gabimet e bëra duke i vlerësuar dhe korrigjuar nga vetë ai.Të aftësohet në perceptimin e disa ideve fundamentale në fushën e sintaksës si degë tjetër e gramatikës;

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të përforcojë njohuritë e tij gramatikore, dhe nëpërmjet tyre aftësinë ligjërimore në gjuhë të huaj;
- 2.Të bëjë analizën morfemore dhe fjalëformuese, në bazë të njohurive të marra;
- 3.Të jetë i aftë të analizojë një tekst të çfarëdoshëm;

Rezultate të pritshme:

- 1.Përvetësimi i koncepteve bazë gramatikore – Studenti do të jetë në gjendje të përcaktojë dhe të diferencojë konceptet themelore të morfologjisë dhe sintaksës,
- 2.Zhvillimi i kompetencës gjuhësore – Studenti do të përdorë në mënyrë të saktë dhe të rrjedhshme strukturat gramatikore në gjuhën e huaj, duke shfaqur aftësi në ndërtimin e fjalive të sakta dhe të mirëstrukturuara.
- 3.Aftësia analitike dhe vetëvlerësuese – Studenti do të jetë në gjendje të analizojë forma gjuhësore, të identifikojë dhe korrigjojë gabimet, si dhe të shprehë gjykime të arsyetuara mbi përdorimin gramatikor.
- 4.Zbatimi praktik i njohurive gramatikore – Studenti do të arrijë të bëjë analiza morfemore dhe fjalëformuese të teksteve të ndryshme, duke aplikuar në mënyrë aktive njohuritë e fituara në kontekste të ndryshme komunikimi.